



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	24.07.2019
REFERENC-Ë:	337 / 19
PËR/ZA/TO:	AK – “Komuna Deçan” OE – “AL Engineering”shpk
NGA/OD/FROM:	Goran Milenković Kryetar i Panelit Shqyrtues-OSHP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	N J O F T I M



Operatori Ekonomik: OE - “AL Engineering”shpk si palë e pa kënaqur më datën: 24.06.2019, ka parashtruar ankesë me nr. 337 / 19, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, kundër njoftimit për dhënie kontratës lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull: "Hartimi – Përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese" me nr. të Prokurimit : 631-19-2855-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK-Deçan” duke pretenduar se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së,

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 27.06.2019, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve ankimore të OE – “AL Engineering”shpk

Eksperti i OSHP-së më datën: 08.07.2019, ka dorëzuar raportin me të gjitha sqarimet dhe rekomandimin e tij lidhur me ankesën e lartpërmendur, me ç’rast ka vlerësuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës OE – “AL Engineering”shpk është e bazuara dhe rrjedhimisht ka rekomanduar panelin shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e OE- ankues dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **RI - VLERSIM**

Me datën: 08.07.2019, Autoriteti Kontraktues: AK - “KK-Deçan” si dhe parashtruesi i ankesës: OE- “AL Engineering”shpk e kanë pranuar raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Hartimi – Përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese" me nr. të Prokurimit : 631-19-2855-2-2-1

Autoriteti kontraktues AK- "KK-Deçan" përmes parashtresës së datës: 09.07.2019, pas pranimi të raportit të ekspertit shqyrtues ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 08.07.2019

Operatori ekonomik: OE "AL Engineering" shpk përmes parashtresës së datës: 10.07.2019 ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 08.07.2019

Paneli Shqyrtues, njofton OE ankues dhe Autoritetin Kontraktues, se konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues: AK- "KK-Deçan" lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Hartimi – Përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese" me nr. të Prokurimit : 631-19-2855-2-2-1 të **RI-VLERESOHET** ky aktivitet i prokurimit sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues, zbatimin e rekomandimit të ekspertit shqyrtues, dhe në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues OE – "AL Engineering" shpk konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përbërja e Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković _____ Kryetari i Panelit Shqyrtues,

z. Nuhi Paçarizi _____ Referues,

z. Blerim Dina _____ Anëtar.